



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. Prot. 6/1

Tiranë, më 17/10/2025

Lënda: Përcillet Vendimi i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

FAKULTETIT TË MJEKËSISË
FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE
FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE

KË T U

Për dijeni:

PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI
REKTOR I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Z. ARLIND BROCI
ADMINISTRATOR I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

KË T U

Bashkëlidhur ju përcjellim Vendimin nr. 2, datë 17.10.2025, të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë *“Për shpalljen e thirrjes së aplikimeve për kandidatët për anëtar të komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “doktor” në njësitet kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”*.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. Prot. 6

Tiranë, më 17 / 10 / 2025

V E N D I M

Nr. 2 datë, 17.10.2025

PËR
SHPLLJEN E THIRRJES SË APLIKIMEVE
PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR
DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" NË NJËSITË KRYESORE NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në zbatim të neneve 4, 5, 6 e vijues të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"; të Urdhrit të Rektorit të UMT-së nr. 93, date 13.10.2025, "Për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar të Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"; të Urdhrit të Rektorit të UMT-së nr. 94, date 13.10.2025, "Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.10.2025,

VENDOSI:

- 1- Të shpallë hapjen e aplikimeve për kandidatët për anëtar të komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore "Doktor" në njësitë kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
- 2- Trupa zgjedhore përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore përkatëse.
- 3- Pranimi i aplikimeve fillon **nga data 27.10.2025 deri më datë 31.10.2025, nga ora 09:00 - deri në orën 16:00**. Dokumentacioni për aplikim do të depozitohet brenda këtij afati, në strukturat përkatëse të burimeve njerëzore të njësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- 4- Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore në UMT, janë si më poshtë:
 - a) Të jetë personel akademik me kohë të plotë në njësinë kryesore përkatëse në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
 - b) Të mbajë titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar";
 - c) Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal;
 - d) Të mos jetë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - e) Të mos jetë marrë masë disiplinore ndaj tij;

- f) Të mos ketë shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar dhe ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- g) Të mos jetë anëtar në më shumë se 2 (dy) komisione të përhershme.
- 5- Dokumentacioni që duhet të dorëzojë për aplikim kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në UMT, është si më poshtë:
- a) Kopje e dokumentit të Identifikimit ID/ Pasaportë;
- b) Kopje të njësuar me origjinalin të diplomës/dëshmisë së titullit akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” ose vërtetim të lëshuar nga UMT-ja në mungesë të diplomës/dëshmisë;
- c) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore;
- d) Vetëdeklarim që nuk ka masë disiplinore;
- e) Vetëdeklarim që nuk është drejtues në njësi kryesore të UMT-së;
- f) Vetëdeklarim se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit” i ndryshuar, dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, si dhe që nuk është anëtar në jo më shumë se 2 (dy) komisione të përhershme.
- 6- Bashkëlidhur këtij Vendimi miratohet dhe fleta e aplikimit të kandidatëve të interesuar.
- 7- Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, drejtuesit e njësive kryesore dhe Komisionet e Zgjedhjeve të Fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- 8- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT, afishohet në mjediset e njësive kryesore dhe publikohet në faqet e tyre zyrtare.

KRYETARI

Myzafer Kaçaj

ANËTARËT

Adela Perolla

Edlira Rruçi

Daniela Tasha

Fatmir Lela

Gentjan Asllanaj

Arnold Rrushhi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. Prot. _____

Tiranë, më ____/____/2025

FLETË APLIKIMI

**PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS
SHKENCORE "DOKTOR" NË FAKULTETIN E _____
TË UMT-së**

Në zbatim të nenit 46 i ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh*", të nenit 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe të Rregullores "*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë*",

Unë, i nënshkruari/e nënshkruara _____ paraqes kandidaturën time për për anëtar/e në Komisionin e Përhershëm të për dhënien e gradës shkencore "Doktor" në Fakultetin e _____ në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të këtij komisioni, të shpallur me Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. 94, date 13.10.2025, "*Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë*".

Emër/ Atësi/ Mbiemër: _____

Datëlindja: ____/____/____

Gjinia: _____

Kategoria (Prof./ Prof Asoc.): _____

Në zbatim të nenit 32 pika 5 e Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, deklaroj se nuk jam anëtar në më shumë se dy komisione të përhershme në UMT; deklaroj që nuk jam në ndjekje penale dhe i/e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale; deklaroj se ndaj meje nuk është marrë masë e sigurimit personal; deklaroj se nuk kam shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*" dhe ligjit nr.45/2015 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*"; deklaroj se nuk jam drejtues në njësi kryesore të UMT-së, si dhe deklaroj se ndaj meje nuk ka masë disiplinore.

Bashkëlidhur:

- Kopje e dokumentit të identifikimit.
- Kopje e njësuar me origjinalin e dëshmisë/ diplomës së titullit akademik "Profesor"/ "Profesor i Asociuar" ose vërtetim të lëshuar nga UMT-ja në mungesë të diplomës/dëshmisë.
- Formulari i deklarimit të gjendjes gjyqësore (bashkëlidhur).

Aplikues

Emër, Mbiemër, Firmë

Kjo fletë aplikimi duhet të depozitohet në Strukturën e Burimeve njerëzore të fakultetit përkatës të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit

Mbiemri, emri	
Atësia/amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam ☐ i/e padënuar

☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARUESIT

Emër, mbiemër/firmë

Emër, mbiemër/firmë/vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.